



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:046099

Datë: 25.11.2022

Numri i dokumentit: 03691241

**PS.nr.12/2022**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti Special** - trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Lutfi Shala kryetar, Kujtim Krasniqi dhe Mentor Bajraktari anëtarë, me pjesëmarrjen bashkëpunëtores profesionale Luljeta Gashi Metaj, duke vendosur në çështjen penale kundër të akuzuarve A.D. dhe D. S., të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.21/2018, të datës 23.04.2020, për shkak të veprave penale secili veç e veç Kontrabandë me mallra nga neni 317 par.1 të KPRK-së dhe Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të datës 10.10.2022, ku prezentë ishin nga Prokuroria Speciale e Kosovës prokurori Burim Çerkini, i akuzuari A. D. dhe mbrojtësi i tij av.Nebojsha Vlajic, i akuzuari D. S. dhe mbrojtësi i tij av. Hasan Hoti, gjykata me datë 13.10.2022 mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**I.A. D.**, nga i ati S. dhe e ëma S., e vajzërisë R., i lindur më dt...., në fshatin D., komuna L., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal:., serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

**II.D. S.**, nga i ati R. dhe e ëma B., e vajzërisë P., i lindur më dt..., në N. P., S., tani me vendbanim në rr."B. B." nr..., L., ka të kryer Fakultetin e inxhinierisë, me profesion tregtar, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal:..., serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

**JANË FAJTOR**

**Sepse:**

I. Që nga vitit 2016 e deri në vitin 2019, në vazhdimësi të pandehurit A.D dhe D.S, me qëllim të përfitimit material të kundërligjshëm kanë kontrabnuar mallra dhe atë mallra ushqimore, drunjte, barna dhe derivate nga Republika e Serbisë për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, duke iu shmangur kontrollit doganor dhe tarifave doganore me rastin e importimit dhe eksportimit të mallrave, në atë mënyrë që duke bashkëpunuar me tani të pandehurit R.R, M. J,

A. V. B, V. D, I. U. dhe D. R, në cilësinë e personave zyrtar në Policinë e Kosovës dhe SPMK-L të Republikës së Kosovës, me c'rast kanë përfituar shuma të konsiderueshme të parave dhe i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material buxhetit të Republikës së Kosovës.

- **Me këtë secili veç e veç ka kryer veprën penale Kontrabandë me mallra nga neni 317 par.1 të KPRK-së.**

II. Që nga viti 2016 e deri në vitin 2019, në vazhdimësi, të pandehurit A. D. dhe D.S, me qëllim të kalimit të mallrave kontrabandë nga Republika e Serbisë për në Republikën e Kosovës dhe anasjelltas, u kanë dhënë shuma të parave apo përfitim tjetër personave zyrtar – policeve të SPMK në L., në mënyrë që personat zyrtar të veprojnë ose të mos veprojnë në kundërshtim me detyrën e tyre zyrtare, ku me të njëjtit janë dakorduar që me rastin e kalimit të mallrave të paguajnë shuma të parave sipas tarifave të përcaktuara për çdo automjet dhe atë nga 20 Euro për vetura të vogla, 30 – 50 Euro për furgona dhe 100-150 Euro për çdo kamion, e që këto shuma të parave i kanë paguar tek zyrtaret policor por edhe i kanë lenë nëpër vend të caktuara si tek pompa e derivateve “Ç.”, dyqani “T M.” si dhe në veturën e tani të pandehurit M. J. – L., ku pas hetimit nga ana e policisë edhe janë arrestuar,

- **Me këtë secili veç e veç ka kryer veprën penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të nenit 237 par. 4 nën par. 4.2 të KPPRK-së, të akuzuarit **A.D.** dhe **D.S** për veprat penale të lartpërmendura.

## **LIROHEN NGA DËNIMI**

Për shkak se të njëjtit kanë qenë dëshmitar bashkëpunues të shpallur sipas urdhrit të gjykatës **PPPS.nr.52/2019, të dt: 18.12.2019, dhe urdhrit PS.nr.20/2020 të dt:18.06.2020.**

**OBLIGOHEN** të akuzuarit A. D. dhe D.S që secili veç e veç, në emër të paushallit gjyqësor gjykatës të ia kompensoi shumën prej **30 euro**, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej **50 euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m i**

Prokuroria Speciale e Kosovës, me datë 23.04.2020, ka ngritur aktakuzën PPS.nr.21/2018 ndaj të pandehurve A. V. B, V.D dhe I. U, për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprat penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar nga neni 283 par.1 të KPRK-së lidhur me veprat penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.2 nën par 2.3 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe Marrje e ryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK-së, si dhe ndaj të pandehurit A. D. dhe D.S, për shkak të veprave penale secili veç e veç Kontrabandë me mallra nga neni 317 par.1 të KPRK-së dhe Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale Gjykata ka marrë aktvendim me të cilin është veçuar procedura penale e të pandehurve A. D. dhe D.S nga procedura penale ndaj të pandehurve A. V. B, V. D dhe I.U.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti Special me aktgjykim PS.nr.11/2021 të dt.15.03.2021 të akuzuarit A.D dhe D.S i ka shpallë fajtorë për veprën penale Kontrabandë me mallra nga neni 317 par.1 të KPRK-së, të njëjtit janë dënuar me dënim me gjobë, ndërsa për veprën penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 të KPRK-së, në bazë të nenit 73 të KPRK-së, i ka liruar nga dënimi.

Gjykata e Apelit Departamenti Special me Aktgjykimin ASP.nr.21/21 të dt:14.09.2021, ka refuzuar ankesat e mbrojtësve të akuzuarve A.D av. Nebojsa Vlajic dhe të akuzuarit D.S av. Hasan Hoti, ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special PS.nr.11/2021 të dt.15.03.2021.

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me aktgjykim Pml.nr.15/2022 të datës 15.02.2022 ka aprovuar kërkesën e përbashkët për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve A.D dhe D.S, ka anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore Departamenti Special në Prishtinë PS.nr.11/2021 të dt.15.03.2021 dhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit Departamenti Special ASP.nr.21/21 të dt:14.09.2021 dhe çështjen penale e ka kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, sipas rekomandimit të Gjykatës së Supreme të Republikës së Kosovës, ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me dt:10.10.2022, duke vlerësuar se Gjykata Supreme ka vendosur me aktgjykim se në këtë çështje penale ka përfunduar faza e shqyrtimit fillestar dhe të shqyrtimit të dytë ka vazhduar me shqyrtim gjyqësor.

Të akuzuarit në bazë të nenit 323 të KPPK-së, janë udhëzuar me të drejtat e tyre ligjore dhe pas deklarimit të prokurorit të shtetit për qëndrimet në raport me urdhrat dhe vërejtjet e dhëna nga gjykata supreme si dhe mendimin e mbrojtësve të akuzuarve, dhe pas leximit të aktakuzës të akuzuarit janë udhëzuar mbi të drejtat për deklarimin e pranimit apo mos pranimit të fajësisë, në këtë drejtim të akuzuarit janë njoftuar nga gjykata për pasojat që rezultojnë nga pranimi i fajësisë, të akuzuarit A.D dhe D.S në këtë shqyrtim gjyqësor janë deklaruar se e pranojnë fajësinë për veprat penale ashtu siç i ngarkon akuza, dhe të gjykohen si dëshmitar bashkëpunues.

Pas pranimit të fajësisë gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të pandehurve, lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë dhe atë sanksionin penal për veprën penale që parashihet, se nuk do të mund t'i kundërshtojë provat apo të parashtrijë prova në këtë çështje penale, se nuk do mund ta atakojnë vendimin e gjykatës lidhur me vërtetimin jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por se mund ta atakojë për shkak të lartësisë mbi dënimin dhe se deklarimi mbi pranimin e fajësisë gjykata detyrimisht duhet ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese.

**Mbrojtësi i të akuzuarit A.D av. Nebojsa Vlajic lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar:** se i mbrojturi i tij me rastin e pranimit të fajësisë është konsultuar mjaftueshëm dhe se të mbrojturit të tij ia shpjeguar të gjitha pasojat dhe benefitet që sjell pranimi i fajësisë andaj i vetë di shpesh për të gjitha këto i njëjti pajtohet që ta pranojë fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

**Mbrojtësi i të akuzuarit D.S av. Hasan Hoti lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar:** se i mbrojturi i tij me rastin e pranimit të fajësisë është konsultuar mjaftueshëm dhe se të mbrojturit të tij ia shpjeguar të gjitha pasojat dhe benefitet që sjell pranimi

i fajësisë andaj i vetë dijshtëm për të gjitha këto i njëjti pajtohet që ta pranojë fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze, dhe njëkohësisht i njëjti të mos dënohet.

**Prokurori i Prokurorisë Speciale Burim Çerkini lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve deklaroi se:** pajtohet me pranimin e fajësisë.

Pas deklarimit të të akuzuarve se ndjehen fajtor për veprat penale për të cilat i ngarkon aktakuza „gjkata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga të akuzuarit pasi që është bindur plotësisht se të njëjtit ishin të vetëdijshtëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Trupi gjykues vlerëson se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë behet vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, materialet e prezantuara nga Prokurori e shtetit e që janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprat penale të cilat i vihet në barrë.

Gjkata me pranimin e fajësisë nga të akuzuarit ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarimet e pranimin të fajësisë nga të akuzuarit dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprave penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprave penale që kanë kryer të akuzuarit, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarimet e pranimin të fajësisë nga të akuzuarit i ka pranuar si të tilla.

Pasi që i akuzuari e pranoi fajësinë dhe gjykata me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë, shqyrtimi gjyqësor vazhdoi me fjalën përfundimtare të palëve.

**Prokurori i Prokurorisë Speciale i Republikës së Kosovës** gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar sikur në shqyrtimin e kaluar mbetem në tërësi pranë kualifikimit juridik të veprave penale të paraqitura në aktakuzë për të akuzuarit A.D dhe D.S dhe të njëjtit për këto vepra penale kanë pranuar fajësinë edhe me rastin ku të njëjti janë shpallur dëshmitar bashkëpunues. Tutje thekson se konform nenit 248 të KPPRK-së, sa i përket propozimit për dënim të njëjtit e kanë dhënë kontributin e tyre si dëshmitar bashkëpunues për veprën penale dhënia e ryshfetit i ka propozuar gjykatës të njëjtit të shpallen fajtor dhe të lirohen nga dënimi, ndërsa për veprën penale kontrabandë me mallra t’ju shqiptohet një dënim për të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit gjithmonë duke u thirrur në aktgjykimin e Gjykatës Supreme që të mos i shqiptohet dënim me i lartë se ai që është shqiptuar, ndërsa lidhur me qëndrimin për urdhrin dhe vërejtjet e gjykatës supreme ka theksuar se urdhri për shpalljen e këtyre si dëshmitar bashkëpunues në kohën kur është bërë kishte mundur me qenë më i plotësuar edhe me i përcaktuar edhe benefitet që i përfitojnë të njëjtit gjatë kësaj procedure, por duke u bazuar në nenin 237 të KPPRK, urdhri nuk është i pa ligjshëm për mos përmbajtjen e benefiteve përkundër kësaj ne si prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësorë e kemi mbajt fjalën dhe ju kemi ofruar benefite dy të akuzuarve duke u bazuar në urdhrin për shpalljen e dëshmitareve bashkëpunues dhe ky benefit ka qenë propozimi për lirim nga dënimi për veprën penale Dhënie e Ryshfetit dhe kështu ka ndodhur, ne po pajtohemi me aktgjykimin e Gjykatës Supreme ku thotë se baza e lirimin ka qenë gabim domethënë nuk ka qenë baza e lirim konform dispozitat ligjore por të njëjtit janë

liruar në një bazë tjetër. I ka propozuar gjykatës që vetëm të shfrytëzohet bazën ligjore nga neni 237 të KPPRK-së, pjesa tjetër të mbetet e pa ndryshuar.

**Mbrojtësi i të akuzuarit A. D, Av. Nebojsa Vlajic gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar ashtu si në** fjalën hyrëse si dhe tani në fjalën përfundimtare në seancën e kaluar e kam treguar dhe shpjeguar pse një person në të njëjtën kohë nuk mund të jetë edhe dëshmitar bashkëpunues si dhe i pandehur, pranë këtyre të thënave mbetem në tërësi. Tutje shton se në bazë të ligjit neni 237 par 4 të KPPRK-së, i akuzuari duhet të jetë i liruar nga dënimi apo procedura penale duhet të jetë e ndërprerë, të pandehurit A. D të cilit i është premtuar kjo ne prokurori. Ju është premtuar se nëse i ndihmon gjykatës dhe vërtetohet e vërteta, ta thotë të vërtetën do jetë i liruar nga dënimi, ai kështu edhe e ka vepruar dhe i ka besuar prokurorit edhe prokurori në seancën e kaluar si dhe sot i ndërgjegjshëm dhe duke u bazuar e ka pranuar se bashkëpunimi i A.D me prokurorinë ka qenë i suksesshëm dhe me gjykatën, andaj për këtë pret që i akuzuari të jetë i liruar apo të silltet një aktgjykim lirues sepse nuk do të ishte e mirë që aktgjykimi të jetë njëjtë. Ndërsa lidhur me udhëzimet dhe sugjerimet e Gjykatës Supreme ka theksuar se një person në të njëjtën kohë nuk mundet me qenë dëshmitar dhe i akuzuar, edhe pse bëhet fjalë për institucionin e dëshmitarit bashkëpunues këtë e cakton neni 237 par 4.2 , i KPPRK-së, është përcaktuar se urdhëresa për dëshmitar bashkëpunues përmban edhe ndalesën e procedurës ose të vazhdohet me procedurën penale, gjithashtu ndalimin e caktimit të dënimit. Dëshmitari bashkëpunues për atë veprë e cila është në urdhëresë, këtu e kemi këtë rast. I njëjti i ka propozuar gjykatës që në bazë të neni 363 par 1.3 të KPPRK-së, të sjellë aktgjykim refuzues, ta refuzon aktakuzën, si kemi pretenduar në shqyrtim ashtu edhe në ankesë.

**I akuzuari A.D në fjalën përfundimtare deklaron:** se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka tjetër se çka te shtonë.

**Mbrojtësi i të akuzuarit D.S, Av. Hasan Hoti gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se** fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar dhe të njëjtën e elaboroj në shqyrtim gjyqësor. I njëjti ka theksuar se dispozitat që rregullojnë Institutin e dëshmitarëve bashkëpunues janë 135 deri 239 të KPPRK-së, i mbrojturi i tij dëshmitar bashkëpunues më dëshmin e tij e ka përmbush jo një siç kërkon neni 235 por kumulativisht tri (3) kushte nga neni 235 kushti nga par. 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPPRK, ndërsa në nenin 237 par. 4, nën par.4.2 të KPPRK-së, përcakton se Ndalimin e fillimit ose vazhdimin të procedurës penale kundër dëshmitarit bashkëpunues dhe shqiptim të dënimit ndaj dëshmitarit bashkëpunues për veprë penale të përcaktuar në urdhër, kurse në nenin 237 par. 4, nën par.4.3 të KPPRK-së, përcakton Natyrën dhe përmbajtjen e bashkëpunimit të dhënë nga dëshmitari bashkëpunues përkatësisht ne nenin 237 par. 4, nën par.4.4 të KPPRK-së, përcakton kushtet për revokimin e urdhrit. Ndërsa lidhur me udhëzimet dhe sugjerimet e Gjykatës Supreme ka theksuar se nuk ka zgjidhje tjetër në këtë procedurë penale pos veprimi sipas urdhëresës së gjykatës të dt. 18.06.2020. Tutje ka shtuar se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për shpalljen e dëshmitarit bashkëpunues, duke përshtetur kontributin e secilin prej këtyre dëshmitareve bashkëpunues ndaj veprave penale dhe kryesit e tyre, për të cilët janë shpallë dëshmitar bashkëpunues gjithashtu nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme duke filluar nga paragrafi 3 deri ne paragrafin 7 i fundit, faqe 3, të aktgjykimit në mënyrë të pa kontestuar vërtetohet teza e mbrojtjes se ndaj të dy dëshmitareve bashkëpunues kanë përfunduar procedurat e tyre penale në këtë çështje penale, kështu në paragrafin 3, Gjykata Supreme si dhe në paragrafin 7, faqe 3 vërteton dhe konkludon benefitin duhet të ishte i qartë, dhe vazhdon ose ndalimi i fillimit ose të vazhdimin të procedurës penale kundër tyre ose ndalimi i shqiptimit të dënimit”.

**I akuzuari D.S në përfundimtare ka deklaruar** se mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk ka tjetër se çka te shtonë.

Nisur nga rrethanat e vërtetuara në procedurë, nga provat që gjenden në shkresa të lëndës, e po ashtu edhe nga vet pranimin i fajësisë nga të pandehurit, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve A. D dhe D.S, formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprave penale Kontrabandë me mallra nga neni 317 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale u vërtetua se të akuzuarit janë shpallur dëshmitar bashkëpunues sipas urdhrit të gjykatës, i pandehuri A. D sipas urdhrit të gjykatës PPS.nr.52/19 të datës 18.12.2019, dhe i pandehuri D.S sipas urdhrit PS.nr.20/2020 të datës 18.06.2020.

Gjykata ka gjet se deklaratat e të pandehurve në fjalë në lidhje me kontrabandimin në pjesën veriore të Kosovës dhe dhënien e ryshfetit nga ana e tyre zyrtareve policor janë të besueshme dhe bindëse. Po ashtu dëshmitë e tyre janë të hollësishme dhe të përputhshme. Ato janë të logjikshme dhe pa ndonjë kontradiktë materiale.

Po ashtu u vërtetua fakti se në urdhrin PPS.nr.52/19 të datës 18.12.2019, për të akuzuarin A.D është cekur vepra penale Kontrabandë me mallra nga neni 371 par.1 të KPRK-së, ndërsa nuk është cekur vepra penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 të KPRK-së, mirëpo prokurori i prokurorisë speciale në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka propozuar që për veprën penale dhënia e ryshfetit nga neni 429 par. 2 të shpallet fajtor dhe të lirohet nga dënimi.

Ndërsa në urdhrin PS.nr.20/2020 të datës 18.06.2020, për të akuzuarin D. S. janë cekur veprat penale Kontrabandë me mallra nga neni 317 par.1 të KPRK, dhe Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 të KPRK, dhe në raport me këta të akuzuar në urdhrat e lartë cekur nuk janë specifikuar benifitet e përfituara përmes urdhrave me të cilët janë shpallur dëshmitar bashkëpunues pavarësisht se të njëjtit i kanë plotësuar kushtet ligjore që ti përfitojnë këto benefite, por në urdhrat e sipërpërmendur vetëm është konstatuar se janë përmbushur kriteret e parapara në nenin 235 par.1 të KPRK, dhe se deklarimi i dëshmitarëve bashkëpunues është bërë në mënyrë të vullnetshme dhe në marrëveshje të plot për të dëshmuar të vërtetën në procedurë penale.

Po ashtu u vërtetua fakti në urdhrat e lartë cekur nuk janë të specifikuar benifitet e parapara në dispozitën e nenit 237 par.4 nën par.4.2 të KPRK, apo më konkretisht nuk është paraparë se cilat benifite të akuzuarit i gëzojnë me rastin e shpalljes dëshmitar bashkëpunues, në urdhra është cekur vetëm se janë plotësuar kushtet nga neni 235 par.1 të KPRK-së, pra në urdhrat e sipërcituar janë treguar vetëm kushte që të pandehurit i plotësojnë për tu shpallur dëshmitar bashkëpunues por jo edhe benifitet e përcaktuar në nenin 237 të KPRK-së.

Gjykata me rastin e vendosjes ndaj të akuzuarve A. D dhe D.S, për veprat penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 të KPRK-së dhe Kontrabandë me mallra nga neni 317 par.1 të KPRK-së, ashtu siç i ngarkon aktakuza ka zbatuar dispozitën 237 par.4 nën par.4.2, të KPRK-së, ku të akuzuarit i ka shpall fajtor dhe i ka liruar nga dënimi. Gjykata deri te ky vendim ka ardhur duke analizuar dispozitën ligjore të nenit 237 par 4 nën par 4.2 të KPRK-së, në të cilën

shprehimisht është paraparë se “ **Urdhri përcakton: ndalimin e fillimit ose të vazhdimit të procedurës penale kundër dëshmitarit bashkëpunues dhe shqiptimit të dënimit ndaj dëshmitarit bashkëpunues për vepër penale të përcaktuara në urdhër**” gjykata vlerëson se shpallja e dëshmitarit bashkëpunues bëhet me urdhër të gjykatës, ku në mënyrë saktë precizohen përfitimet dhe benefitet e dëshmitarit bashkëpunues për dëshminë e dhënë para prokurorit të shtetit përkatësisht gjykatës. Këto benefite para se gjithash konsistojnë në ndalimin e fillimit ose të vazhdimit të procedurës penale kundër dëshmitarit bashkëpunues dhe shqiptimit të dënimit ndaj dëshmitarit bashkëpunues për vepër penale të përcaktuara në urdhër. Këto përfitime në raport me dëshmitarin bashkëpunues për bashkëpunim me prokurorin e shtetit janë të ndryshme dhe mund t’i ofrohen atij në momente të ndryshme procedurale dhe nga subjekte të ndryshme procedurale. Kështu, ndalimin e fillimit përkatësisht të vazhdimit të procedurës penale mund ta ofrojë prokurori i shtetit para shqyrtimit gjyqësor ndërkaq vendimin mbi ndalimin e shqiptimit përkatësisht lirim nga dënimi gjykata mund ta shqiptojë ekskluzivisht në shqyrtimin gjyqësor.

Andaj, nga sa u tha me lart, në raport me veprën penale Kontrabandë me mallra nga neni 371 par.1 dhe Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 të KPRK-së bazuar në nenin nenit 237 par 4 nen par 4.2 të KPPRK-së, gjykata vlerëson se të akuzuarit A. D dhe D.S me rastin e shpalljes si dëshmitarë bashkëpunues me urdhrin e gjykatës PPPS.nr.52/19 të datës 18.12.2019, për të akuzuarin A. D dhe urdhrin PS.nr.20/2020 të datës 18.06.2020 për të akuzuarin D.S, të njëjtët i kanë plotësuar kushtet ligjore për të përfituar bene fitet të cilat të akuzuarve ligji në fuqi iu ‘a mundëson, të njëjtit gjykata i ka shpallë fajtorë dhe i ka liruar nga dënimi. Gjykata thekson se, urdhri PPPS.nr.52/19 i datës 18.12.2019 të lëshuar për të akuzuarin A.D nuk e përfshin veprën penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 të KPRK-së, megjithatë gjykata bën me dije se kjo vepër penale i është vënë në barrë të akuzuarit përmes aktakuzës PPS.nr 21/2018 të datës 23.04.2020 për të cilat vepra penale i akuzuari A.D nga gjykata është shpallur dëshmitar bashkëpunues andaj gjykata vlerëson se kushti që i akuzuari A. D të përfitojë nga benefitet e nenit 237 par 4 nen par 4.2 të KPPRK-së përmbushet edhe në raport me këtë vepër penale, e të gjendur në një situatë të tillë gjykata ka vendosur që të akuzuarin A. D. për veprën penale Dhënia e ryshfetit nga neni 429 par.2 të KPRK-së ta shpallë fajtor dhe ta lirojë nga dënimi ashtu siç edhe është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes për të akuzuarit A. D dhe D.S ka vlerësuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve, bashkëpunimi me organet e drejtësisë duke u shpallur me urdhër të gjykatës dëshmitarë bashkëpunues dhe më deklaratat e tyre kanë bërë të mundur zbardhjen e të vërtetës në procedurë penale si dhe ndjekjen e suksesshme të kryesve të tjerë të veprës penale konsiderohen *rrethana* të cilat e obligojnë gjykatën konform dispozitës së nenit 237 par 4 nen par 4.2 të KPPRK-së, në të cilën dispozitë shprehimisht është paraparë “**ndalimin e fillimit ose të vazhdimit të procedurës penale kundër dëshmitarit bashkëpunues dhe shqiptimit të dënimit ndaj dëshmitarit bashkëpunues për vepër penale të përcaktuara në urdhër**” andaj gjykata duke zbatuar dispozitën ligjore të lartë cekur të akuzuarit A. D dhe D.S i shpalli fajtorë dhe i lirojë nga dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që vendimin mbi lirim nga dënimi gjykata mund ta shqiptojë ekskluzivisht në shqyrtimin gjyqësor.

Në kuptim të nenit 454 par. 1 KPPK-së, gjykata vendosi që shpenzimet e procedurës penale të bien në llogari të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par 1 dhe 2 nën par 2.6 të KPPRK.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 360, 361 dhe 365 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**- Departamenti Special –**  
**PS.nr.12/2022, me datën 13.10.2022**

**Kryetari i trupit gjykues**  
Lutfi SHALA

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.